



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 22 prill 2022
Nr.ref.:RK 1983/22

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI112/20

Parashtrues

Branislav Gajin

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit
të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 265/2019, të 9 tetorit 2019**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Branislav Gajin, me adresë të përhershme në Beograd të Republikës së Serbisë, të cilin e përfaqëson Naim Rudari, avokat nga Prishtina (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

2. Parashtruesi i kërkesës gjendet në vuajtje të dënimit në Qendrën e Paraburgimit në Mitrovicë.

Vendimi i kontestuar

3. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin [Pml. nr. 265/19] e 9 tetorit 2019, të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme), në ndërlidhje me Aktgjykimin [PAKR. nr. 206/2019] të 16 majit 2019, të Gjykatës së Apelit të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit) dhe Aktgjykimin [DTKD. K. nr. 112/2018] të 4 marsit 2019, të Gjykatës Themelore në Pejë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).
4. Parashtruesi i kërkesës vendimin e kontestuar e ka pranuar më 13 mars 2020.

Objekti i çështjes

5. Objekt i çështjes së kërkesës është shqyrtimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, me të cilin pretendohet të jenë shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës, të garantuara me nenet 21 [Parimet e Përgjithshme], 23 [Dinjiteti i Njeriut], 24 [Barazia para Ligjit], 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë], 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale], 40 [Liria e Shprehjes], 41 [E Drejta e Qasjes në Dokumente Publike], 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave], 59 [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Tyre] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), si dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në paragrafin 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës], 27 [Masat e përkohshme] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

7. Më 13 korrik 2020, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
8. Më 21 korrik 2020, Kryetarja e Gjykatës e caktoi gjyqtaren Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi, (kryesuese), Gresa Caka-Nimani dhe Safet Hoxha (anëtarë).

9. Më 4 gusht 2020, Gjykata e njoftoi përfaqësuesin e parashtruesit të kërkesës për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën ditë, Gjykata e njoftoi Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës.
10. Më 17 gusht 2020, Gjykata kërkoi nga avokati që të dorëzojë autorizimin që dëshmon se ai e përfaqëson parashtruesin e kërkesës para Gjykatës.
11. Më 9 shtator 2020, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë autorizimin e kërkuar.
12. Më 17 maj 2021, bazuar në paragrafin 5 të nenit 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës dhe rregullit 12 (Zgjedhja e Kryetarit dhe e Zëvendëskryetarit) të Rregullores së punës, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani u zgjodh Kryetare e Gjykatës Kushtetuese. Bazuar në paragrafin (4) të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës KK-SP 71-2/21, u përcaktua që gjyqtarja Gresa Caka-Nimani, detyrën e Kryetares së Gjykatës e merr pas përfundimit të mandatit të Kryetares aktuale të Gjykatës, Arta Rama-Hajrizi, më 25 qershor 2021.
13. Më 25 maj 2021, bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 9 (Përfundimi i mandatit para kohës) të Ligjit dhe rregullit 7 (Dorëheqja e gjyqtarëve) të Rregullores së punës, gjyqtari Bekim Sejdiu paraqiti dorëheqjen e tij nga pozita e gjyqtarit pranë Gjykatës Kushtetuese.
14. Më 31 maj 2021, Kryetarja e Gjykatës, Arta Rama-Hajrizi, me Vendimin nr. KK 160/21, përcaktoi që gjyqtarja Gresa Caka-Nimani të caktohej kryesuese e kolegjeve shqyrtuese në rastet në të cilat ajo ishte caktuar anëtare e Kolegjit, duke përfshirë edhe rastin aktual.
15. Më 14 qershor 2021, Gjykata njoftoi edhe Gjykatën Themelore në Pejë për regjistrim të rastit dhe kërkoi nga ajo që në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh të dorëzojë fletëkthesën që dëshmon se kur e ka pranuar parashtruesi i kërkesës Aktgjykimin e kontestuar.
16. Më 17 qershor 2021, Gjykata Themelore në Pejë dorëzoi në Gjykatë fletëkthesën.
17. Më 26 qershor 2021, bazuar në paragrafin (4) të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës [KK-SP-71-2/21], gjyqtarja Gresa Caka-Nimani mori detyrën e Kryetares së Gjykatës, ndërsa bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, kryetarja Arta Rama-Hajrizi përfundoi mandatin e Kryetares dhe të gjyqtarës së Gjykatës Kushtetuese.
18. Më 28 qershor 2021, Kryetarja e Gjykatës Gresa Caka-Nimani, nxori Vendimin [Nr. KSH. KI112/20] dhe emëroi gjyqtarin Radomir Laban në vend të gjyqtarës paraprake Arta Rama-Hajrizi.
19. Më 23 nëntor 2021, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë një “Urgjencë”.

20. Më 9 dhjetor 2021, Gjykata Themelore në Pejë e dorëzoi fletëkthesën që dëshmon se kur parashtruesi i kërkesës e ka pranuar Aktgjykimin [DTKD. K. nr. 112/2018] e Gjykatës Themelore të 4 marsit 2019.
21. Më 9 mars 2022, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarës raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

22. Më 26 dhjetor 2018, Prokuroria Themelore e Republikës së Kosovës, përkatësisht Prokuroria Themelore në Pejë ngriti Aktakuzë [PP/I. nr. 98/2018] kundër parashtruesit të kërkesës nën dyshimin se në bashkëkryerje ka kryer veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 281 në lidhje me nenin 273 dhe 31 të Kodit Penal [Nr. 04/L-082] të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kodi Penal). Me të njëjtën aktakuzë për veprat penale të lartcekura në bashkëkryerje ishin akuzuar edhe personi M. G. dhe R. U.
23. Më 4 mars 2019, Gjykata Themelore, Departamenti për vepra të rënda penale në Pejë në prani të Prokurorit shtetëror, parashtruesit të kërkesës dhe mbrojtësit të tij, nxori Aktgjykimin [DTKD. K. nr. 112/2018], përmes së cilit e shpalli parashtruesin e kërkesës fajtor për kryerje, në bashkëkryerje, të veprës penale - blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 281, paragrafi 1, nënparagrafi 1.9, në lidhje me nenin 273, paragrafi 2 dhe nenin 31 të Kodit Penal. Me atë rast, Gjykata Themelore e dënoi parashtruesin e kërkesës me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) viteve dhe dënim me gjobë në vlerë prej njëmijë (1000) euro, brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve. Gjykata Themelore, gjithashtu në kuadër të dënimit shtesë vendosi që parashtruesit të kërkesës t'i konfiskohen substancat narkotike, vetura bashkë me pajisje të tjera, obligoi që të paguajë shumën prej 175 euro në emër të shpenzimeve të procedurës penale dhe në fund ia vazhdoi paraburgimin parashtruesit të kërkesës deri sa aktgjykimi të bëhet i plotfuqishëm.
24. Sa i përket akuzës ndaj personit M. G. dhe R.U., Gjykata Themelore i liroi nga akuza me arsyetimin se *“nuk është provuar që kanë kryer veprën penale për të cilën akuzohen”*.
25. Më 12 mars 2019, parashtruesit të kërkesës i ishte dorëzuar Aktgjykimi [DTKD. K. nr. 112/2018] i 4 marsit 2019, i Gjykatës Themelore, në Qendrën e Paraburgimit në Mitrovicë.
26. Gjykata Themelore në Aktgjykimin e lartcekur dënues [DTKD.K.nr. 112/2018], ndër të tjera theksoi: *“Duke marrë parasysh që i akuzuari Branislav Gajin, në të gjitha fazat por edhe në shqyrtimin kryesor ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar, e pranimi i fajësisë është provuar edhe nga administrimi i provave në shqyrtimin gjyqësor, Gjykata, nga gjendja e vërtetuar e lartpërmendur dhe për shkak të ruajtjes së identitetit të akuzës, në kuptim të nenit 360, par. 2 të ZKPK-së, duke mos prekur cilësimin e veprës penale që i akuzuari, deri më tani me persona të panjohur, në ditën, kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar në pikën II të dispozitivit të aktakuzës, është*

provuar që ka kryer veprën penale si bashkëkryes të blerjes, posedimit, shpërndarjes dhe shitjes së paautorizuar të narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 281, par. 1, nën par. 1.9, lidhur me 273, par. 2 dhe 31 të ZKPK-së. Kështu Gjykata e gjen fajtor dhe penalisht përgjegjës”.

27. Në një datë të paspecifikuar, kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Themelore [DTKD. K. nr.112/2018], Prokuroria Themelore në Pejë parashtrori ankesë në Gjykatën e Apelit, duke pretenduar shkelje qenësore të dispozitave të procedurës penale, shkelje të ligjit penal, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit mbi sanksionin penal, me propozimin që aktgjykimi të priset dhe rasti të kthehet në rigjykim.
28. Mbrojtja e parashtruesit të kërkesës kishte paraqitur përgjigje në ankesë në Gjykatën e Apelit kundër ankesës së Prokurorisë Themelore në Pejë, duke argumentuar se ankesa e kësaj të fundit duhet të refuzohet si e pabazuar.
29. Më 26 prill 2019, Prokuroria e Apelit përmes parashtresës [PPA/1 nr. 196/19] ka propozuar që të aprovohet ankesa e Prokurorisë Themelore në Pejë, dhe të refuzohet përgjigja e mbrojtjes së parashtruesit të kërkesës.
30. Më 16 maj 2019, Gjykata e Apelit, Departamenti për vepra penale të rënda, në prani të parashtruesit të kërkesës dhe mbrojtësit të tij, përmes Aktgjykimit [PAKR. nr. 206/2019] vendosi si në vijim:

“I. Pjesërisht miratimi i Prokurorisë Themelore në Pejë, ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë, P.nr. 112/18 e datës 04.04.2019, vetëm sa i përket vendimit mbi dënimin, ashtu që Gjykata e Apelit, të akuzuarin Branislav Gajin, për veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 281, par. 1, neni 1.9, në lidhje me nenin 273, par. 2 dhe 31 të KPPK-së, për të cilën është shpallur fajtor, është dënuar me dënim me burg prej 6 (gjashtë) viteve, në dënim do të llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej datës 29.09.2018 e tutje, dhe e merr si të vërtetuar dënimin me gjobë në shumën prej 1.000.00€, në pjesën e dytë të aktgjykimit kundër të akuzuarit Branislav Gajin, mbetet e pandryshuar.

II. Ankesa e mbrojtjes së të akuzuarit Branislav Gajin mbetet e pandryshuar.

III. Ankesa e Prokurorisë Themelore në Pejë, sa i përket të të akuzuarve M. G. dhe R. U. refuzohet si e pabazuar e pjesa e aktgjykimit së lirim të vërtetohet”.

31. Gjykata e Apelit në Aktgjykimin e saj arsyetoi se “Vlerësimi i rrethanave lehtësuese mbi matjen e dënimin e pranon edhe kjo gjykatë dhe vlerëson që gjykata e shkallës së parë gabimisht ka vërtetuar e nuk ka gjetur rrethana rënduese nga ana e të akuzuarve dhe për këtë nuk ka marrë parasysh mënyrën sipas së cilës është kryer vepra penale edhe pse i akuzuari disa ditë para se të kryhet vepra, ka sjellë rimorkion nga Serbia në Kosovë me qëllim që të modifikohet dhe të përgatitet për fshehjen e narkotikut, e gjithë kjo dërgon që me vullnetin dhe vendosmërinë e tij ka kryer veprën penale, veprimi i tij e bën edhe më të rrezikshëm për shoqërinë. Me praninë e këtyre rrethanave rënduese, sipas vlerësimit të kësaj gjykate, dënimi i cili i është shqiptuar të

akuzuarit është i butë, me të cilin i jepte vërejtje prokurorit në ankesën e tij sepse sasia e madhe e narkotikut nuk mund të vlerësohet si rrethanë rënduese sikurse theksohet në ankesë sepse është karakteristikë e elementit të veprës, neni 281, par. 1 nën par. 1, pika 9 i KPPK-së për të cilën ky i akuzuar është shpallur fajtor”.

32. Më 14 gusht 2019, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit [PAKR. nr. 206/2019] të Gjykatës së Apelit, të 16 majit 2019 dhe Aktgjykimit [DTKD. K. nr. 112/2018] të Gjykatës Themelore, të 4 marsit 2018. Në kërkesën e tij, parashtruesi i kërkesës pretendonte: (i) shkelje të nenit 477, paragrafi 4 dhe nenit 478, paragrafi 1 të Kodit [04-L-123] të Procedurës Penale (në tekstin e mëtejme: Kodi i Procedurës Penale) me arsyetimin se Aktgjykimi [DTKD. K. nr. 112/2018] i Gjykatës Themelore nuk i ishte dorëzuar personalisht atij në mënyrë që të kishte mundësinë që të deklarohej lidhur me vendimin; (ii) si dhe shkelje të nenit 105, 106, 107 dhe 108 të Kodit të Procedurës Penale sepse gjatë fazës së kontrollit nga policia, nuk ishte prezent personalisht.
33. Më 9 tetor 2019, Gjykata Supreme, përmes Aktgjykimit [Pml. nr. 265/2019] refuzoi kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë me arsyetimin se nuk ka shkelje të ligjit penal.
34. Gjykata Supreme në Aktgjykimin e saj theksoi: *“Në rastin konkret, gjykata e shkallës së parë ka shqiptuar llojin e dënimit për këtë vepër penale e cila është e parashikuar me ligj. Gjykata e Apelit duke pasur parasysh edhe ato rrethana rënduese, të dënuarit i ka shqiptuar dënimin më të rëndë dhe ka ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë në pjesën që ka të bëjë me dënimin, dhe për këto arsye nuk ka mundur të pranojë pretendimin nga kërkesa mbi ekzistimin e shkeljes së ligjit penal. Kur nuk ekziston shkelja e përmendur, vendimi për dënimin me këtë mjet të jashtëzakonshëm mund të kundërshtohet vetëm në rastin kur është marrë aktgjykimi i marrë me shkelje të rëndësishme të procedurës penale e cila mund të jetë me ndikim, dmth. e cila do të ndikonte në mungesën dhe paqartësinë e arsyeve të dhëna në vendimin mbi dënimin. Në rastin konkret, një pretendim i tillë në kërkesë nuk është paraqitur”.*
35. Parashtruesi i kërkesës pretendon se më 6 dhjetor 2019, kishte pranuar personalisht Aktgjykimin [DTKD.K.nr.112/2018] e Gjykatës Themelore të 4 marsit 2019.
36. Si rezultat i kësaj, më 10 dhjetor 2019, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit [DTKD.K.nr.112/2018] të Gjykatës Themelore.
37. Më 17 janar 2020, Gjykata e Apelit duke iu përgjigjur ankesës së parashtruesit të kërkesës, lëshoi një *“Shënim Zyrtar”* duke njoftuar parashtruesin e kërkesës se *“Gjykata e Apelit, duke vepruar sipas dispozitave ligjore sipas nenit 390, par. 1 i KPPK-së, ka caktuar për datën 16.05.2019, seancën e kolegjit të Gjykatës së Apelit / Departamenti për vepra të rënda penale, për shkak të shqyrtimit të ankesave të theksuara. Në seancën e kolegjit të mbajtur ditën e përmendur, të pranishëm kanë qenë: i pandehuri **Branislav Gajin** i cili është sjellë nga Qendra e paraburgimit, mbrojtësi, av. Haxhi Çekaj,*

mbrojtësi i të pandehurit të dytë R.U., av. Osman Cucoviq, dhe përkthyesi gjyqësor i Gjykatës së Apelit M.H.. Palët tjera kanë munguar, pasi që në mënyrë të rregullt kanë lajmëruar gjykatën për seancë në përputhje me nenin 390, par. 4 të KPRK-së për mungesën e tyre. Mbrojtësi i të pandehurit Branislav Gajin, av. Haxhi Çekaj ka paraqitur theksimet nga ankesa, të cilat në tërësi i ka arsyetuar dhe tani i dënuari, (atëherë i pandehur) Branislav Gajin”.

38. Gjykata e Apelit, ndër të tjera, arsyetoi se *“Nga shikimi në procesverbal të Kolegjit, rezulton që i pandehuri fare nuk ka përmendur faktin që në asnjë mënyrë nuk pajtohet me ankesën e përmendur nga ana e mbrojtësit të tij dhe as nuk i ka dhënë gjykatës ndonjë informatë që nuk ka pranuar aktgjykimin. Gjyqtari raportues i ka raportuar aktgjykimin në seancën e kolegjit, raportimi i cili ka përkthyer të pandehurin nga ana e përkthyesit të gjykatës dhe lidhur me këtë i pandehuri nuk ka pasur asnjë vërejtje”.*
39. Në fund, Gjykata e Apelit, theksoi: *“Pasi që ankesa e të pandehurit nuk ka qenë objekt i shqyrtimit të kolegjit të Gjykatës së Apelit sepse e njëjta është parashtruar (më 24.12.2019 kur është dorëzuar në Gjykatën themelore në Pejë), gjyqtarja referuese nuk e sheh të arsyeshme që të ndërmerr ndonjë veprim në lidhje me ankesën e parashtruar, sepse në këtë gjykatë, ashtu si është lartpërmendur, janë shqyrtuar ankesat, është marrë aktgjykim, derisa në Gjykatën Supreme është marrë aktgjykim sipas kërkesës së të dënuarit për mbrojtje të ligjshmërisë”.*
40. Më 10 shkurt 2020, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, duke kontestuar shkresën e 17 janarit 2020 të Gjykatës së Apelit, me arsyetimin se janë shkelur dispozitat e procedurës penale të cilat kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor.
41. Gjykata vëren se as nga dosja e lëndës, por as nga vetë parashtruesi i kërkesës, Gjykata nuk ka njohuri nëse Gjykata Supreme ka nxjerrë ndonjë përgjigje në lidhje me ankesën e 10 shkurtit 2020 të paraqitur nga ana e parashtruesit të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

42. Parashtruesi i kërkesës pretendon që Aktgjykimin PML. nr. 265/2019 i Gjykatës Supreme i 9 tetorit 2019, është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me nenet 21 [Parimet e Përgjithshme], 23 [Dinjiteti i Njeriut], 24 [Barazia para Ligjit], 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë], 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale], 40 [Liria e Shprehjes], 41 [E Drejta e Qasjes në Dokumente Publike], 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave], dhe 59 [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Tyre] të Kushtetutës.
43. Parashtruesi i kërkesës konsideron se shkelja e neneve 30, 31 dhe 32 të Kushtetutës ka ndodhur si pasojë e mosdorëzimit të Aktgjykimit [DTKD. K. nr. 112/2018] të Gjykatës Themelore, të 4 marsit 2019, në mënyrë që parashtruesi i kërkesës të kishte mundësi që ta ankimonte vendimin në Gjykatën e Apelit.

44. Parashtruesi i kërkesës po ashtu thekson se pas pranimit të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, nga ana e tij, ai ka paraqitur ankesë në Gjykatën e Apelit, por kjo e fundit nuk ka trajtuar ankesën e tij por vetëm i është përgjigjur përmes një shënimi zyrtar.
45. Në lidhje me procedurën e zhvilluar në Gjykatën e Apelit si rezultat i ankesës së Prokurorisë, parashtruesi i kërkesës nënvizoi: *“Më lejoni të theksoj faktin se më 16 maj 2019. Gjatë seancës së Kolegjit të Apelit nuk e kam theksuar mospajtimin tim me ankesën e mbrojtësit tim sepse nuk më është dorëzuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore, i cili për mua ka qenë totalisht i panjohur në seancë dhe përmbajtjen e aktgjykimit, u lexua, jo gojarisht dhe në seancë nuk pata kohë të mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen time, e cila parashikohet me Kushtetutë në nenin 30, paragrafi 1, paragrafi 3 [...]”*.
46. Parashtruesi i kërkesës pretendon se *“Shkelja e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, rezulton me prishjen e aktgjykimit të shkallës së parë dhe pranimin e pjesshëm të ankesës së Prokurorisë Themelore në Pejë, duke e rritur dënimin nga 4 (katër) deri në 6 (gjashtë) vjet”*.
47. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit të saj nuk kishte arsyetuar/trajtuar pretendimin e tij kryesor për shkelje të nenit 478, paragrafi 4 në lidhje me nenin 477, paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale, si rezultat i mosdorëzimit të vendimit të Gjykatës Themelore dhe rrjedhimisht pamundësisë së tij që ta kundërshtonte përmes ankesës në Gjykatën e Apelit.
48. Në këtë kontekst, parashtruesi i kërkesës thekson: *“Mosdorëzimi i Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë, Gjykata e Apelit në Prishtinë ka caktuar seancën e Kolegjit me datën 16.05.2019 kurse mua personalisht si i dënuar nuk janë krijuar kushtet ligjore për të mbajtur seancën dhe njëjta mund të vërehet nga shkresat e lëndës se mua ende nuk më është dorëzuar Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë dhe në vend që të shtyhet seanca e Kolegjit të Apelit, në dorëzimin e aktgjykimit dhe afatit ankimor të cilën parasheh KPPRK dhe më garanton Kushtetuta personalisht të deklarohej personalisht si i pandehur [...]”*.
49. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që *“Të anulohet aktgjykimi që tani ka marrë formë të prerë dhe çështja të kthehet në rigjykim dhe rivendosje edhe një herë me ç’ rast të pandehurit Gajin t’i ipet mundësia që ta atakojë aktgjykimin e shkallës së parë dhe të rigjykohet ngase i njëjti është dënuar shumë rëndë”*.
50. Në fund, parashtruesi i kërkesës po ashtu thekson: *“[...] të anulohet Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit në Prishtinë - Hajvalia nr. PAKR - 206/2019 e datës 16 maj 2019, të mbahet seanca e re e Kolegjit të Apelit ku do të jetë subjekt- Lënda e shqyrtimit edhe ankesa ime - i pandehuri (i dënuar), të cilin e kam përpiluar në përputhje me dispozitat ligjore dhe më lejon mua si të gjithë qytetarët e tjerë të Republikës së Kosovës t’i gëzoj të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me Kushtetutën e Kosovës në rastin tim, të parashikuara në nenet 30 dhe 32”*.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

- 1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*
- 2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.*
- 3. Gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata, në rrethana të veçanta, konsideron se, në të mirë të drejtësisë, është i domosdoshëm përjashtimi i publikut, ose i përfaqësuesve të mediave, sepse prania e tyre do të përbënte rrezik për rendin publik ose sigurinë kombëtare, interesat e të miturve, ose për mbrojtjen e jetës private të palëve në proces, në mënyrën e përcaktuar me ligj.*
- 4. Çdokush i akuzuar për vepër penale ka të drejtë t'u bëjë pyetje dëshmitarëve dhe të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.*
- 5. Çdokush i akuzuar për vepër penale, prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij/saj, në pajtim me ligjin.*

Neni 32 [E Drejta për Mjete Juridike]

Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj.

KONVENTA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Neni 6 (E drejta për një proces të rregullt)

- 1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohej shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohej nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.*
- 2. Çdo person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht.*

**KAPITULLI XXIII
VEPRAT PENALE TË NARKOTIKËVE**

Neni 273

Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge

1. Kushdo që pa autorizim blen ose posedon me qëllim të shitjes apo shpërndarjes, ose ofron për shitje substanca apo preparate të cilat janë shpallur me ligj si narkotikë, substanca psikotrope apo substanca analoge, dënohet me gjobë dhe me burgim prej dy (2) deri në tetë (8) vjet.

2. Kushdo që pa autorizim shpërndan, shet, transporton, dorëzon, ndërmjetëson, dërgon ose dërgon në transit substanca apo preparate të cilat janë shpallur me ligj si narkotikë, substanca psikotrope ose substanca analoge, me qëllim të shpërndarjes, shitjes ose ofrimit për shitje, dënohet me gjobë dhe me burgim prej dy (2) deri në dymbëdhjetë (12) vjet.

3. Kushdo që pa autorizim eksporton ose importon substanca apo preparate të cilat janë shpallur me ligj si narkotikë, substanca psikotrope ose substanca analoge, dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) deri në dhjetë (10) vjet.

4. Për qëllime të këtij kapitulli, shprehja “analog” nënkupton çfarëdo substance e cila nuk është e autorizuar dhe struktura kimike e së cilës është esencialisht e ngjashme me atë të substancave apo preparateve që janë shpallur si narkotikë ose substanca psikotrope dhe efektet e të cilave i riprodhon.

5. Substancat narkotike, substancat psikotrope ose substancat analoge dhe mjetet për prodhimin, shpërndarjen apo transportimin e tyre konfiskohen.

Neni 281

Dënimi për raste të rënda të veprave penale nga ky Kapitull

1. Nëse vepra penale nga nenet 273, 274, 275, 276 ose 278 të këtij Kodi kryhet në një ose më shumë nga rrethanat në vijim, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) deri në pesëmbëdhjetë (15) vjet, nëse:

- 1.1. kryesi vepron si anëtar i grupit;*
- 1.2. kryesi është person zyrtar në keqpërdorim të pozitës apo autorizimeve të tij;*
- 1.3. kryesi përdor ose kanos se do ta përdorë dhunën ose armën;*
- 1.4. vepra kryhet në dëm ose duke e shfrytëzuar viktimën e ndjeshme;*

- 1.5. *dërgesa, ngarkesa, kontejneri ose mjete i planifikuar për një operacion humanitar është përdorur për transportimin e paligjshëm të narkotikëve, substancave psikotrope ose substancave analoge;*
- 1.6. *personi ka përzier substancat narkotike, substancat psikotrope ose substancat analoge me substanca të tjera të cilat e shtojnë rrezikun për shëndetin;*
- 1.7. *vepra është kryer brenda perimetrit prej treqind e pesëdhjetë (350) metrash nga shkolla apo mjedisi tjetër që përdoret nga fëmijët ose brenda perimetrit prej treqind e pesëdhjetë (350) metrash nga cilido institucion i edukimit;*
- 1.8. *vepra penale kryhet brenda institucionit korrektues;*
- 1.9. *vepra penale përfshin sasi të mëdha të narkotikëve, substancave psikotrope ose substancave analoge.*

2. Substancat narkotike, substancat psikotrope ose substancat analoge dhe mjetet për prodhimin, shpërndarjen apo transportimin e tyre konfiskohen.

KODI Nr. 04/L-123 I PROCEDURËS PENALE

Neni 395 Reformatio in Peius

Në qoftë se është paraqitur ankesë vetëm në dobi të të akuzuarit, aktgjykimi përsa i përket cilësimit juridik të veprës dhe sanksionit penal nuk mund të ndryshohet në dëm të tij.

Neni 474 Komunikimi i vendimeve

1. Në qoftë se ky kod nuk parasheh ndryshe, vendimet u komunikohen palëve të interesuara gojarisht nëse janë të pranishëm, e kur mungojnë atyre u dërgohet kopja e vërtetuar.

2. Kur vendimi komunikohet gojarisht shënohet në procesverbal ose në shkresë, kurse personi të cilit i është dërguar vendimi, marrjen e vërteton me nënshkrimin e tij. Kur personi i interesuar deklaron se nuk do të ankohet, kopja e vërtetuar e vendimit të komunikuar gojarisht nuk i dërgohet po që se me këtë kod nuk është paraparë ndryshe.

3. Kopjet e vendimeve kundër të cilëve lejohet ankesë dërgohen së bashku me udhëzim për të drejtën në ankesë.

Neni 477 Alternativat e dorëzimit personal

1. Shkresa, për të cilën me këtë kod nuk është paraparë dorëzim detyrues personal, dorëzohet gjithashtu personalisht, por kur marrësi nuk gjendet në banesë ose në vendin e punës, shkresa e tillë mund t'i dorëzohet ndonjërit nga anëtarët e rritur të familjes së tij i cili detyrohet ta pranojë shkresën. Në qoftë se ata nuk gjenden në shtëpi, shkresa i dorëzohet kujdestarit ose fqinjit, në qoftë se ai pajtohet ta pranojë atë. Kur dërgimi bëhet në vendin e punës së personit i cili duhet të pranojë shkresën, ndërsa ai nuk gjendet aty, mund t'i dorëzohet personit të autorizuar për marrjen e postës i cili detyrohet ta pranojë shkresën, ose personit të punësuar në të njëjtin vend pune në qoftë se ai pajtohet ta pranojë shkresën

[...]

Neni 478

Shkresat që duhet dorëzuar personalisht

1. Të pandehurit personalisht i dorëzohet thirrja për marrje në pyetje në procedurë paraprake dhe për shqyrtim gjyqësor.

2. Të pandehurit i cili nuk ka mbrojtës i dërgohet personalisht aktakuza, aktgjykimi dhe vendimet tjera për të cilat afati i ankesës fillon nga dita e dorëzimit, duke përfshirë edhe ankesën e palës kundërshtare të dorëzuar për përgjigje. Me kërkesën e të pandehurit, aktgjykimi dhe vendimet tjera i dorëzohen personit të caktuar nga ai.

3. Në qoftë se të pandehurit i cili nuk ka mbrojtës duhet dorëzuar aktgjykimin me të cilin i është shqiptuar dënimi me burgim, kurse aktgjykimi nuk mund t'i dërgohet në adresën e tij të mëparshme, gjykata menjëherë i cakton mbrojtës të pandehurit, i cili e ushtron këtë detyrë derisa të gjindet adresa e re e të pandehurit. Mbrojtësit të caktuar i lihet afat i nevojshëm për t'u njoftuar me shkresat, e pastaj i dorëzohet aktgjykimi dhe vazhdon procedura. Në rast të ndonjë vendimi tjetër për të cilin data e dorëzimit konsiderohet si datë e fillimit të ecjes së afatit për parashtrimin e ankesës, ose në rastin e ankesës së palës kundërshtare e cila dorëzohet për përgjigje dhe dërguesi nuk ka mundur ta gjej adresën e re të të pandehurit, vendimi apo ankesa vihet në stendën e gjykatës dhe pas tetë (8) ditëve nga dita e vënies në stendë dërgesa konsiderohet valide.

4. Në qoftë se i pandehuri ka mbrojtës, shkresa nga paragrafi 2. i këtij neni i dërgohet mbrojtësit dhe të pandehurit në pajtim me dispozitat e nenit 477 të këtij kodi. Në rastin e tillë, afati për ushtrimin e mjetit juridik apo të përgjigjes në ankesë rrjedhë nga dita e dorëzimit të shkresës të pandehurit. Kur të pandehurit nuk mund t'i dorëzohet vendimi apo ankesa për shkak të mosdhënies së adresës, ato vihen në stendën e gjykatës dhe pas tetë (8) ditëve nga dita e vënies në stendë dërgesa konsiderohet valide.

5. Kur shkresa duhet dorëzuar mbrojtësit të të pandehurit dhe i pandehuri ka më shumë se një mbrojtës, mjafton t'i dorëzohet njërit prej tyre.

Neni 479

Procedura e dorëzimit

- 1. Marrësi dhe dërguesi e nënshkruajnë fletëdërgesën për të vërtetuar dorëzimin. Marrësi në fletëdërgesë shënon personalisht datën e pranimit.*
- 2. Në qoftë se marrësi nuk di shkrim ose nuk është në gjendje të nënshkruajë emrin e tij, për të nënshkruhet dërguesi duke e shënuar ditën e dorëzimit dhe arsyen përse është nënshkruar në vend të marrësit.*
- 3. Kur marrësi refuzon të nënshkruajë fletëdërgesën, dërguesi këtë e shënon në fletëdërgesë si dhe ditën e dorëzimit të dërgesës, ndërsa dërgimi konsiderohet valid.*

Pranueshmëria e kërkesës

51. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.
52. Në këtë drejtim, Gjykata, fillimisht, i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

53. Gjykata, gjithashtu, shqyrton nëse parashtuesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të kërkuara me nenet 47 [Kërkesat individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
[Afati]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...]”.

54. Sa i përket përmbushjes së kriterëve të mësipërme, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston akt të një autoriteti publik, respektivisht Aktgjykimin e Gjykatës Supreme [Pml. nr. 265/2019], të 9 tetorit 2019, pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike. Parashtruesi i kërkesës po ashtu i ka sqaruar pretendimet e tij për ato të drejta dhe liri që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kushtet që kërkojnë nga neni 48 i Ligjit. Ai po ashtu e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.

55. Megjithatë, përveç kësaj, Gjykata gjithashtu duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e tjera të pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Specifikisht, rregulli 39 (2) i Rregullores së punës përcakton që:

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

56. Gjykata fillimisht rikujton që parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me nenet 21 [Parimet e Përgjithshme], 23 [Dinjiteti i Njeriut], 24 [Barazia para Ligjit], 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë], 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale], 40 [Liria e Shprehjes], 41 [E Drejta e Qasjes në Dokumente Publike], 54 [Mbrotjtja Gjyqësore e të Drejtave], 59 [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Tyre] të Kushtetutës si dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

57. Gjykata rikujton se rrethanat e rastit ndërlidhen me Aktakuzën [PP/I. nr. 98/2018] e ngritur nga Prokuroria Themelore e Republikës së Kosovës, përkatësisht Prokuroria Themelore në Pejë kundër parashtruesit të kërkesës nën dyshimin se në bashkëkryerje ka kryer veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 281 në lidhje me nenin 273 dhe 31 të Kodit Penal.

58. Parashtruesi i kërkesës ishte shpallur fajtor për veprën penale – blerje, posedim, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve nga paragrafi 1.9 i nenit 281 në lidhje me nenin 273, paragrafi 2 dhe 3 të Kodit Penal. Bazuar në aktakuzën e ngritur në vitin 2018, parashtruesi i kërkesës ishte shpallur fillimisht i fajshëm përmes Aktgjykimit [DTKD. K. nr. 112/2018] të Gjykatës

Themelore, të 4 marsit 2019, i cili vendim parashtuesit të kërkesës i ishte dorëzuar më 12 mars 2019 në Qendrën e Paraburgimit në Mitrovicë. Më pas, Aktgjykimi i Gjykatës Themelore ishte ankimuar në Gjykatën e Apelit nga Prokuroria Themelore e Pejës. Gjykata e Apelit pas analizimit të ankesës së Prokurorisë Themelore të Pejës, argumenteve të mbrojtjes së parashtuesit të kërkesës, përmes Aktgjykimit [PAKR. nr. 206/2019] ndryshoi Aktgjykimin [P. nr. 112/18] e Gjykatës Themelore të 4 marsit 2019, duke ngritur dënimin për parashtuesin e kërkesës nga 4 (katër) në 6 (gjashtë) vjet. Aktgjykim ky i cili, pas refuzimit të kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, ishte vërtetuar nga Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Pml. nr. 265/2019] të 9 tetorit 2019. Më pas, parashtuesi i kërkesës kishte paraqitur ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit [DTKD.K.nr. 112/2018] të Gjykatës Themelore. Gjykata e Apelit duke iu përgjigjur ankesës së parashtuesit të kërkesës, lëshoi një “Shënim Zyrtar”. Parashtuesi i kërkesës paraqiti kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën e Supreme duke kontestuar shkresën e 17 janarit 2020 të Gjykatës së Apelit. Gjykata thekson se as nga dosja e lëndës por as nga vetë parashtuesi i kërkesës, nuk ka njohuri nëse Gjykata Supreme ka nxjerrë ndonjë përgjigje në lidhje me ankesën e 10 shkurtit 2020 të paraqitur nga ana e parashtuesit të kërkesës. Shpalljen e fajësisë nga ana e Gjykatës Themelore ndaj parashtuesit të kërkesës dhe më pas ngritjen e dënimit nga ana e Gjykatës së Apelit janë çështje të cilat parashtuesi i kërkesës i ngre para Gjykatës me pretendimin qendror se ky i fundit nuk kishte mundësi që ta ankimonte aktgjykimin dënues të Gjykatës Themelore sepse nuk i ishte dorëzuar vendimi dhe se ndryshimi i Aktgjykimit të Gjykatës Themelore përmes Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit ishte bërë në dëm të tij.

59. Gjykata thekson se pretendimet thelbësore të parashtuesit të kërkesës ndërliiden me **(i)** mungesën e kohës për ta përgatitur mbrojtjen gjatë zhvillimit të seancës së Gjykatës së Apelit, të 16 majit 2019; mos plotësimi i kushteve ligjore për zhvillimin e kësaj seance; **(ii)** shkelja e parimit *refformatio in peius* në dëm të parashtuesit të kërkesës nga ana e Gjykatës së Apelit; dhe **(iii)** pamundësinë për ta goditur Aktgjykimin [DTKD. K. nr. 112/2018] e Gjykatës Themelore, të 4 marsit 2019 si rezultat i mospranimit të këtij Aktgjykimi; mostrajtimi i ankesës së parashtuesit të kërkesës, së 10 dhjetorit 2019 nga ana e Gjykatës së Apelit; mosadresimi i pretendimit të parashtuesit të kërkesës nga ana e Gjykatës Supreme për mospranim të vendimit të Gjykatës Themelore.
60. Gjykata, në vijim, do të trajtojë veç e veç secilin pretendim të parashtuesit të kërkesës, duke aplikuar praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mbi bazën e të cilës Gjykata, bazuar në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
61. Në këtë aspekt, Gjykata thekson se praktika e GJEDNJ-së përcakton se drejtësia e një procedure vlerësohet në bazë të procedurës si tërësi (shih, në këtë kontekst, rastin e GJEDNJ-së *Barbera, Messeque dhe Jabardo kundër Spanjës*, Aktgjykim i 6 dhjetorit 1988, paragrafi 68). Rrjedhimisht, gjatë vlerësimit të pretendimeve të parashtuesit të kërkesës, Gjykata gjithashtu do t'i përmbahet këtij parimi (shih rastin e Gjykatës KI104/16, parashtues *Miodrag Pavić*, Aktgjykim i 4 gushtit 2017, paragrafi 38; dhe rastin KI143/16,

parashtrues *Muharrem Blaku dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, i 13 qershorit 2018, paragrafi 31).

Pretendimi për shkelje të nenit 30 të Kushtetutës

62. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të nenit 30 [Të drejtat e të Akuzuarit] të Kushtetutës me arsyetimin se nuk ka pasur kohë të mjaftueshme që të përgatit mbrojtjen para Gjykatës së Apelit.
63. Në lidhje me këtë pretendim, parashtruesi i kërkesës thekson: *“Më lejoni të theksoj faktin se më 16 maj 2019, gjatë seancës së Kolegjit të Apelit, nuk e kam theksuar mospajtimin tim me ankesën e mbrojtësit tim, sepse nuk më është dorëzuar Aktgjykimi i Gjykatës Themelore, i cili për mua ka qenë totalisht i panjohur në seancë dhe përmbajtjen e aktgjykimit, u lexua, jo gojarisht dhe në seancë nuk pata kohë të mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen time, e cila parashikohet me Kushtetutë në nenin 30, paragrafi 1, paragrafi 3 [...]”*.
64. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës specifikisht pretendon shkelje të paragrafit 3 të nenit 30 të Kushtetutës, me argumentin se nuk ka pasur kohë të mjaftueshme që të përgatit mbrojtjen gjatë zhvillimit të seancës së Gjykatës së Apelit të 16 majit 2019.
65. Sa i përket këtij pretendimi, respektivisht, nga shkresat e lëndës nuk rezulton se kjo çështje është ngritur përgjatë procedurave para gjykatave të rregullta. Për më tepër, Gjykata vëren se sipas shkresave të lëndës rezulton se kjo çështje nuk është ngritur as para Gjykatës Supreme përmes kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet praktikës së saj gjyqësore dhe asaj të GJENDJ-së, sa i përket kriterit për shterjen e mjeteve juridike në kuptimin substancial.
66. Gjykata fillimisht thekson se, përderisa në kontekstin e mekanizmave për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, rregulli për shterimin e mjeteve juridike duhet të aplikohet me një shkallë fleksibiliteti dhe pa ndonjë formalizëm të tepruar, ky rregull zakonisht kërkon që ankesat e pretendimet që synohen të ngrihen më vonë në proces gjyqësor, duhet të jenë ngritur edhe para gjykatave të rregullta, të paktën në substancë dhe në respektim të kushteve formale dhe afateve të përcaktuara përmes ligjit të aplikueshëm (shih, rastin e GJEDNJ-se, *Jane Nieklinson kundër Mbretërisë së Bashkuar dhe Paul Lamb kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Kërkesat 2478/15 dhe 1787/15, 16 korrik 2015, paragrafi 89 dhe referencat e përfshira aty).
67. Edhe më specifikisht, GJEDNJ mban qëndrimin se, për aq sa ekziston një mjet juridik që ua mundëson gjykatave të rregullta të adresojnë, të paktën në substancë, argumentin për shkelje të një të drejte, atëherë ai mjet juridik duhet të shfrytëzohet. Nëse ankesa e paraqitur në Gjykatë nuk është ngritur, qoftë në mënyrë eksplicite apo në substancë pranë gjykatave të rregullta, kur ka mundur të ngrihet gjatë ushtrimit të një mjeti juridik në dispozicion të parashtruesit të kërkesës, atëherë gjykatave të rregullta u është mohuar mundësia e adresimit të çështjes, mundësi të cilën rregulli për shterimin e mjeteve juridike synon ta ofrojë (shih, rastin e GJEDNJ-së, *Jane Nieklinson kundër Mbretërisë së*

Bashkuar dhe Paul Lamb kundër Mbretërisë së Bashkuar, cituar më lart, paragrafi 90 dhe referencat e përfshira aty).

68. Rrjedhimisht, Gjykata thekson se shterimi i mjeteve juridike ngërthen në vete dy elemente: (i) atë të shterimit në kuptimin formal-procedural, që nënkupton mundësinë e përdorimit të mjetit juridik, kundër një akti të një autoriteti publik, në një instancë më të lartë me juridiksion të plotë; dhe (ii) shterimin e mjetit në kuptimin substancial, që nënkupton raportimin e shkeljeve kushtetuese në “substancë” para gjykatave të rregullta, në mënyrë që këto të fundit të kenë mundësinë e parandalimit dhe të korrigjimit të shkeljes së të drejtave të njeriut të mbrojtura me Kushtetutë dhe KEDNJ. Gjykata i konsideron si të shterura mjetet juridike vetëm atëherë kur parashtruesit e kërkesës, në pajtueshmëri me ligjet në fuqi, i kanë shfrytëzuar ato, në të dyja kuptimet (shih, po ashtu, rastin e Gjykatës Kushtetuese, KI71/18, parashtrues *Kamer Borovci, Mustafë Borovci dhe Avdulla Bajra*, Aktvendim për papranueshmëri, i 21 nëntorit 2018, paragrafit 57).
69. Marrë parasysh këto parime dhe në rrethana në të cilat, sipas shkresave të lëndës rezulton se ky pretendim specifik i parashtruesit të kërkesës është ngritur për herë të parë para Gjykatës, ajo konkludon që parashtruesi i kërkesës nuk ua ka dhënë mundësinë gjykatave të rregullta, respektivisht Gjykatës Supreme, të adresojë këtë pretendim dhe me atë rast, të parandalojnë shkeljet e pretenduara që parashtruesi i kërkesës i ngre drejtpërdrejt pranë kësaj Gjykate, pa i shteruar mjetet juridike në kuptimin e tyre substancial (shih, *mutatis mutandis*, rastin e Gjykatës Kushtetuese, KI118/15, parashtrues *Dragiša Stojković*, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 prillit 2016, paragrafët 30-36).
70. Si rrjedhojë, për sa i përket këtij pretendimi, respektivisht pretendimit për mungesë të kohës së mjaftueshme që të përgatit mbrojtjen para Gjykatës së Apelit, Gjykata konstaton se duhet të refuzohet si pretendim i papranueshëm në baza procedurale për shkak të mosshterimit substancial të të gjitha mjeteve juridike siç kërkohet me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, paragrafin 2 të nenit 47 të Ligjit dhe pikën (b) të paragrafit (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

Pretendimi për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës si rezultat i ngritjes së dënimit në dëm të parashtruesit, shkeljes së parimit *reformatio in peius*, gjatë shqyrtimit të çështjes

71. Gjykata vëren se, në thelb, parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të parimit “*reformatio in peius*” në dëm të tij, d.m.th., shfrytëzimi i të drejtës për t’u ankuar nuk guxon që ta përkeqësojë pozitën e tij procedurale. Gjykata rithekson pretendimin e parashtruesit të kërkesës: “*shkelja e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, rezulton me prishjen e aktgjyqimit të shkallës së parë dhe pranimin e pjesshëm të ankesës së Prokurorisë Themelore në Pejë, duke e rritur dënimin nga 4 (katër) deri në 6 (gjashtë) vjet*”.
72. Gjykata vëren se parimi “*reformatio in peius*” gëzon mbrojtje nga neni 31 i Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 të KEDNJ-së sepse ka të bëjë me të drejtën e individit për t’u ankuar.

73. Çështja nëse është shkelur ose jo parimi “*reformatio in peius*” do të shtjellohet në paragrafët e mëposhtëm, duke marrë parasysh: (i) procedurat e zhvilluara në tërësinë e tyre; (ii) kriteret dhe kufizimet e procedurës kushtetuese në rastet individuale; dhe, (iii) jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ), duke pasur parasysh nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës.
74. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se praktika e GJEDNJ-së përcakton se drejtësia e një procedure vlerësohet në tërësi (shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së të 6 dhjetorit 1988, *Barbera, Messeque dhe Jabardo kundër Spanjës*, nr. 10590/83, paragrafi 68). Rrjedhimisht, gjatë vlerësimit të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata gjithashtu do t’i përmbahet këtij parimi (shih, rastin e Gjykatës nr. KI104/16, parashtrues *Miodrag Pavić*, Aktgjykim i 4 gushtit 2017, paragrafi 38; dhe rastin nr. KI143/16, parashtrues *Muharrem Blaku dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, i 13 qershorit 2018, paragrafi 31).
75. Në këtë drejtim, për t’i shmangur keqkuptimet nga ana e parashtruesit të kërkesës, duhet pasur parasysh se “drejtësia” që kërkohet me nenin 31 nuk është drejtësi “substanciale”, por drejtësi “procedurale”. Në terma praktik, dhe në parim, kjo shprehet me procedurë kontradiktore, ku palët dëgjohen dhe vendosen në kushte të njëjta në gjykatë (shih, *mutatis mutandis*, rastin e Gjykatës nr. KI42/16 parashtrues *Valdet Sutaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 7 nëntorit 2016, paragrafi 41 dhe referencat tjera të përmendura aty).
76. Në rastin konkret, Gjykata vëren se Prokuroria Themelore në Pejë kishte kërkuar dënim më të ashpër për parashtruesin e kërkesës në të dy instancat gjyqësore.
77. Në këtë kontekst, Gjykata vëren në Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit se Prokuroria Themelore nuk ishte pajtuar me shqiptimin e dënimit nga ana e Gjykatës Themelore, e cila në fund rezultoi me paraqitjen e ankesës nga kjo e fundit në shkallën e dytë, duke argumentuar se “[...] dënimi i parashikuar për veprën penale për të cilën është dënuar Branislav është nga tre deri në pesë vite, gjykata ka shqiptuar një dënim minimal edhe pse nuk e ka arsyetuar me provat dhe faktet dhe ka vlerësuar që nuk ka gjetur rrethana rënduese dhe nuk ka marrë parasysh faktin që i njëjti është polic, person zyrtar, nuk ka bashkëpunim me organet për zbulimin e kryesit nga i cili është furnizuar me narkotikë, është rrezik i madh shoqëror sasia e cila është konfiskuar. Gjykata ka marrë parasysh rrethanën lehtësuese, atë të moshës së re edhe pse këtu bëhet fjalë për person 32 vjeçar”.
78. Gjykata vëren se Aktgjykimi i Gjykatës Themelore është ndryshuar me aprovimin e pjesshëm të ankesës së Prokurorisë Themelore dhe sipas detyrës zyrtare.
79. Gjykata vëren se në rastin konkret dënimi më i ashpër ndaj parashtruesit të kërkesës është caktuar në shkallën e dytë, respektivisht nga Gjykata e Apelit pas iniciimit të ankesës së Prokurorisë Themelore, çka është çështje diskrecionale e gjykatave të rregullta.

80. Gjykata po ashtu vëren se gjykatat e rregullta kanë zbatuar testin e proporcionalitetit ndërmjet ashpërsisë së dënimit, rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe efektit të dënimit për parandalimin e kryerjes së veprave penale të ngjashme në të ardhmen.

81. Në këtë kontekst, Gjykata vëren se Gjykata e Apelit ngritjen e dënimit nga 4 vjet burgim në 6 vjet burgim për parashtruesin e kërkesës, e kishte arsyetuar si në vijim:

“Gjykata e shkallës së parë kur ka caktuar lartësinë e dënimit të të akuzuarit Branislav ka marrë të gjitha rrethanat, neni 73 i KPK-së. Rrethana rënduese nuk ka gjetur dhe si rrethana rënduese ka marrë pranimin e fajësisë për pjesën e veprimeve për të cilat mendon që është përgjegjës, paraprakisht nuk ka qenë i dënuar, sjellja e tij para dhe pas kryerjes së veprës penale, që ka mbajtur familjen, është i moshës së re dhe që pendohet thellë. Vlerësimi i rrethanave lehtësuese mbi matjen e dënimit e pranon edhe kjo gjykatë dhe vlerëson që gjykata e shkallës së parë gabimisht ka vërtetuar e nuk ka gjetur rrethana rënduese nga ana e të akuzuarve dhe për këtë nuk ka marrë parasysht mënyrën sipas së cilës është kryer vepra penale edhe pse i akuzuari disa ditë para se të kryhet vepra, ka sjellë rimorkion nga Serbia në Kosovë me qëllim që të modifikohet dhe të përgatitet për fshehjen e narkotikut, e gjithë kjo dërgon që me vullnetin dhe vendosmërinë e tij ka kryer veprën penale, veprimi i tij e bën edhe më të rrezikshëm për shoqërinë. Me praninë e këtyre rrethanave rënduese, sipas vlerësimit të kësaj gjykate, dënimi i cili i është shqiptuar të akuzuarit është i butë, me të cilin i jepet vërejtje prokurorit në ankesën e tij sepse sasia e madhe e narkotikut nuk mund të vlerësohet si rrethanë rënduese sikurse theksohet në ankesë sepse është karakteristikë e elementit të veprës, neni 281, par. 1 nën par. 1, pika 9 i KPPK-së për të cilën ky i akuzuar është shpallur fajtor. Për këtë Gjykata e Apelit e ka ndryshuar aktgjykimin e kundërshtuar dhe të akuzuarin e ka dënuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi me bindje që dënimi është në përputhje me interesin e zhdëmtimit të vlerës që mbrohen me shkeljen e përgjithshme si kryes të veprës penale dhe që me këtë dënim do të arrihet dënimi i nenit 41 të KP-së”.

82. Veç kësaj, Gjykata vëren se parashtruesit të kërkesës i është mundësuar zhvillimi i procedurës bazuar në parimin e kontradiktoritetit; se ai ka mundur që gjatë fazave të ndryshme të procedurës të paraqiste argumente dhe dëshmi që ai i konsideronte relevante për rastin e tij; se atij i është dhënë mundësia që të kontestonte në mënyrë efektive argumentet dhe dëshmitë e paraqitura nga pala kundërshtare; dhe se të gjitha argumentet, shikuar objektivisht, që ishin relevante për zgjidhjen e rastit të tij ishin dëgjuar e shqyrtuar në mënyrë të rregullt nga gjykatat; se arsyet faktike e ligjore ndaj vendimeve të goditura ishin shtruar hollësisht; dhe se, në përputhje me rrethanat e rastit, procedurat, shikuar në tërësinë e tyre, ishin të drejta (shih, ndër të tjera, *mutatis mutandis*, rastin e Gjykatës nr. KI118/17, parashtrues Sani Kervan dhe të tjerët, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 shkurtit 2018, paragrafi 35; shih, po ashtu, rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, GJEDNJ, kërkesa nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 29).

83. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se nuk është detyrë e saj që të merret me gabimet e ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta (ligjshmërisë), përveç dhe për aq sa gabimet e tilla mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë). Ajo vetë nuk mund të vlerësojë ligjin që ka çuar një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “shkallës së katërt”, që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta t’i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, rastin *García Ruiz kundër Spanjës*, GJEDNJ nr. 30544/96, i 21 janarit 1999, paragrafi 28; dhe shih, gjithashtu, rastin e Gjykatës nr. KI70/11, parashtrues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).
84. Gjykata më tej vëren se parashtruesi i kërkesës nuk pajtohet me rezultatin e procedurës së zhvilluar në gjykatat e rregullta. Megjithatë, pakënaqësia e parashtruesit të kërkesës me rezultatin e procedurës nga gjykatat e rregullta nuk mund vetvetiu të ngrejë pretendim të argumentueshëm për shkeljen e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm (shih, *mutatis mutandis*, rastin *Mezotur - Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, GJEDNJ, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21; dhe shih, gjithashtu, rastin e Gjykatës nr. KI56/17, parashtruese *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 42).
85. Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk i ka mbështetur pretendimet se procedurat përkatëse në ndonjë mënyrë ishin të padrejta apo arbitrare dhe se me vendimet e kontestuara janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë dhe me KEDNJ (shih, *mutatis mutandis*, *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendimi i 30 qershorit 2009).

Pretendimi për shkelje të nenit 32 të Kushtetutës si rezultat i pamundësisë për ta goditur vendimin e Gjykatës Themelore

86. Gjykata vëren se përkitazi me shkeljet e pretenduara të nenit 32 [E drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës e ndërlikon këtë pretendim me mospasjen e mundësisë që ta apelojë Aktgjykimin [DTKD. K. nr.112/2018] e Gjykatës Themelore të 4 marsit 2019, në Gjykatën e Apelit me arsyetimin se nuk i ishte dorëzuar atij personalisht.
87. Në këtë aspekt, Gjykata do t’i referohet nenit 380 [Ankesa kundër Aktgjykimit] të Kodit të Procedurës Penale, i cili përcakton se “*ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit*”.
88. Gjithashtu, Gjykata do t’i referohet nenit 474 [Komunikimi i vendimeve] dhe nenit 479 [Procedura e dorëzimit] të Kodit të Procedurës Penale.
89. Neni 474 [Komunikimi i vendimeve] i Kodit të Procedurës Penale përcakton si në vijim:

[...]

1. Në qoftë se ky kod nuk parasheh ndryshe, vendimet u komunikohen palëve të interesuara gojarisht nëse janë të pranishëm, e kur mungojnë atyre u dërgohet kopja e vërtetuar.

2. Kur vendimi komunikohet gojarisht shënohet në procesverbal ose në shkresë, kurse personi të cilit i është dërguar vendimi, marrjen e vërteton me nënshkrimin e tij. Kur personi i interesuar deklaron se nuk do të ankohet, kopja e vërtetuar e vendimit të komunikuar gojarisht nuk i dërgohet po që se me këtë kod nuk është paraparë ndryshe.

90. Neni 479 [Procedura e dorëzimit] i Kodit të Procedurës Penale përcakton si në vijim:

1. Marrësi dhe dërguesi e nënshkruajnë fletëdërgesën për të vërtetuar dorëzimin. Marrësi në fletëdërgesë shënon personalisht datën e pranimit.

[...]

91. Në lidhje me këtë, Gjykata pas analizimit të të gjitha shkresave të lëndës vëren se Gjykata Themelore - vendimin e saj e kishte nxjerrë më 4 mars 2019, ndërsa në bazë të fletëkthesës së dorëzuar nga Gjykata Themelore në Pejë, rezultoi se Aktgjykimi i Gjykatës Themelore ishte dorëzuar në Qendrën e Paraburgimit në Mitrovicë, më 12 mars 2019.
92. Për më tepër, Gjykata vëren se në përmbajtjen e fletëkthesës janë të reflektuara të gjitha të dhënat relevante si shifra [P. nr. 112/18] dhe data e nxjerrjes së Aktgjykimit të Gjykatës Themelore; data se kur i është dorëzuar postës për shpërndarje; data se kur është pranuar Aktgjykimi; numri i shkresave, emri i parashtruesit të kërkesës dhe adresa për dorëzimin e vendimit në Qendrën e Paraburgimit në Mitrovicë.
93. Gjykata vëren se fletëkthesa ishte nënshkruar nga pranuesi në cilësinë e marrësit të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore më 12 mars 2019 në Qendrën e Paraburgimit në Mitrovicë.
94. Gjithashtu, Gjykata vëren se fletëkthesa ishte nënshkruar edhe nga dorëzuesi në cilësinë e dërguesit të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore tek parashtruesi i kërkesës më 12 mars 2019 në Qendrën e Paraburgimit në Mitrovicë.
95. Në këtë aspekt, Gjykata thekson se nënshkrimi i fletëkthesës nga ana e pranuesit në njërin anë dhe dërguesit në anën tjetër vërtetojnë qartë dorëzimin e Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Qendrën e Paraburgimit në Mitrovicë.
96. Përveç kësaj, Gjykata vëren se Aktgjykimi [DTKD.K.nr.112/2018] i Gjykatës Themelore i 4 marsit 2019, ishte shpallur publikisht pas mbajtjes së seancës kryesore më 4 mars 2019, në prani të Prokurorit të Shtetit dhe parashtruesit të kërkesës bashkë me avokatin e tij.

97. Në lidhje me këtë dhe në lidhje me pretendimin për mungesë të njohurisë lidhur me përmbajtjen e vendimit të shkallës së parë, Gjykata Themelore në Aktgjykim e saj kishte reflektuar prezencën e palëve relevante në rastin si në vijim:

“[...] pas mbajtjes së seancës kryesore në prani të Prokurorit shtetëror - Sahide Gashi, të akuzuarit Branislav Gajin, mbrojtësit, av. Haxhi Çekaj, të akuzuarit M. G., mbrojtësit. Av. Gani Kelmendi dhe të akuzuarit R. U., mbrojtësit, av. Osman Cucoviq, më 04.03.2019, merr dhe publikisht shpallë këtë Aktgjykim [...]”.

98. Gjithashtu, në lidhje me pretendimin për pamundësinë për ta paraqitur ankesën kundër vendimit të Gjykatës Themelore, Gjykata vëren se në procedurën gjyqësore para Gjykatës së Apelit të iniciuar përmes ankesës së Prokurorit të Shtetit, mbrojtja e parashtruesit të kërkesës kishte paraqitur përgjigje/shkresë me propozimin që ankesa e prokurorisë së shtetit të refuzohet.
99. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se Gjykata e Apelit kishte theksuar se “Gjykata e Apelit ka shqyrtuar aktgjykimin e kundërshtuar në bazë të nenit 394, par. 1 të KPPK-së, ka vlerësuar pretendimet e prokurorit të Prokurorisë Themelore në Pejë dhe të mbrojtësit të të pandehurit dhe së bashku me të gjitha shkresat tjera të lëndës, pas vlerësimit konstaton [...]”.
100. Në vazhdim, Gjykata vëren se Gjykata e Apelit në Aktgjykimin e saj, kishte vlerësuar edhe ankesën dhe pretendimet e parashtruesit të kërkesës, duke theksuar: “Nga rrethanat e fakteve të cilat janë përshkruar, ankesa e të akuzuarit pavarësisht në aktvendimin e dënimit, refuzohet si e pabazuar sepse nuk është theksuar ndonjë rrethanë e re e cila nuk është vlerësuar e cila do të sillte deri tek një dënim më i butë”.
101. Nën dritën e kësaj, Gjykata vëren se Gjykata e Apelit gjatë procedurës së vendimmarrjes kishte vlerësuar pretendimet edhe të Prokurorit të Shtetit dhe të parashtruesit të kërkesës lidhur me kontestimin e Aktgjykimit të Gjykatës Themelore dhe në fund kishte vendosur për aprovimin e pjesshëm të ankesës së paraqitur dhe duke refuzuar kështu pretendimet e parashtruesit të kërkesës (shih paragrafin 28-30).
102. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë drejtuar Gjykatës Supreme kishte pretenduar se “Mosdorëzimi personal i aktgjykimit k.nr.112/2018 tek unë, ndjeshëm ka ndikuar në ligjshmërinë e vendimmarrjes për arsye se nuk më është mundësuar që edhe unë personalisht të deklarohej mbi aktgjykimin e cituar. Neni 478, par.4 në lidhje me nenin 477, par.1 i KPPRK-se janë shkelur në dëm timin, edhe pse dorëzimi personalisht i aktgjykimit i përket normave të domosdoshme”.
103. Në lidhje me këtë, para kësaj Gjykate parashtruesi i kërkesës thekson: “[...] Gjykata Supreme shkel nenin 32 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, kur në tërë përmbajtjen e aktgjykimit fare nuk e përmendet apo nuk e arsyeton çështjen e prezantuar në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, duke shkelur në dëm tim nenin 478, paragrafi 4 lidhur me nenin 477, paragrafi 1 - dhe se dorëzimi i aktgjykimit paraqet normë imperative, e cila tek unë, ka ndikuar në

ligjshmërinë e marrjes së vendimit gjyqësor dhe ka shkaktuar ndërprerje - pamundësia që unë personalisht si i pandehur të paraqes ankesë kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë, nr. DTKD.112 / 2018 nga 04.03.2019. vjet. Shkelja thelbësore e dispozitave ligjore si neni 478, paragrafi 4 lidhur me nenin 477 paragrafi 1, në të njëjtën kohë përbën shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. [...]”.

104. Gjykata vëren se në esencë, parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit të saj nuk kishte arsyetuar/trajtuar pretendimin e tij kryesor për shkelje të nenit 478, paragrafi 4 në lidhje me nenin 477, paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale, si rezultat i mosdorëzimit të vendimit të Gjykatës Themelore tek parashtruesi i kërkesës dhe, rrjedhimisht, pamundësisë së tij që ta kundërshtonte përmes ankesës në Gjykatën e Apelit.
105. Në këtë aspekt, Gjykata fillimisht vëren se Gjykata Supreme në Aktgjykimin e saj kishte shqyrtuar kërkesën e parashtruesit të kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë duke adresuar pretendimet e tij thelbësore lidhur me mos prezencën e tij dhe të avokatit gjatë kontrollit nga ana e Policisë; dhënia e dëshmisë pa prezencën e avokatit të tij; mos konsiderimin e rrethanave lehtësuese gjatë shqiptimit të dënimit nga ana e Gjykatës së Apelit dhe në fund Gjykata Supreme kishte argumentuar refuzimin e kërkesës së tij. Arsyet për refuzimin e kërkesës së parashtruesit të kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, Gjykata Supreme i kishte bazuar në dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurës Penale që ajo i kishte konsideruar si relevante përkitazi me rrethanat e rastit konkret dhe përkitazi me pretendimet thelbësore të ngritura nga parashtruesi i kërkesës.
106. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet pjesës relevante të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, e cila kishte theksuar si në vijim:

“Në rastin konkret, gjykata e shkallës së parë ka shqiptuar llojin e dënimit për këtë vepër penale e cila është e parashikuar me ligj. Gjykata e Apelit duke pasur parasysh edhe ato rrethana rënduese, të dënuarit i ka shqiptuar dënimin më të rëndë dhe ka ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë në pjesën që ka të bëjë me dënimin, dhe për këto arsye nuk ka mundur të pranojë pretendimin nga kërkesa mbi ekzistimin e shkeljes së ligjit penal.

Kur nuk ekziston shkelja e përmendur, vendimi për dënimin me këtë mjet të jashtëzakonshëm mund të kundërshtohet vetëm në rastin kur është marrë aktgjykimi i marrë me shkelje të rëndësishme të procedurës penale e cila mund të jetë me ndikim, dmth. e cila do të ndikonte në mungesën dhe paqartësinë e arsyeve të dhëna në vendimin mbi dënimin. Në rastin konkret, një pretendim i tillë në kërkesë nuk është paraqitur”.

107. Rrjedhimisht, Gjykata vëren se Gjykata Supreme ka arritur të adresojë kërkesën e parashtruesit të kërkesës duke dhënë përgjigje të zgjeruar në pjesën më të madhe të pretendimeve të ngritura nga ai përmes kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, me përjashtim të adresimit të pretendimit se “Mosdorëzimi personal i aktgjykimit k.nr.112/2018 tek unë, ndjeshëm ka ndikuar në ligjshmërinë e vendimmarrjes për arsye se nuk më është mundur që edhe

unë personalisht të deklarohej mbi aktgjykimin e cituar". Neni 478, par.4 në lidhje me nenin 477, par.1 i KPPRK-se janë shkelur në dëm timin, edhe pse dorëzimi personalisht i aktgjykimit i përket normave të domosdoshme" të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore.

108. Në këtë aspekt, Gjykata ka parasysh pretendimin e parashtruesit të kërkesës se Gjykata Supreme nuk kishte adresuar pretendimin e parashtruesit lidhur me "mosdorëzimin personal" të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore.
109. Lidhur me këtë çështje, Gjykata thekson se parashtruesi i kërkesës përveç që ka ngritur këtë pretendim, ai nuk ka arritur që të argumentojë dhe as që Gjykata mund të konstatojë se mosadresimi i një pretendimi për "mosdorëzimin personal" të Aktgjykimit K.nr.112/2018 ishte vendimtar, apo përcaktues për epilogun e rastit të parashtruesit të kërkesës pasi që në bazë të të gjitha shkresave të lëndës vërehet se Gjykata Themelore - vendimin e saj e kishte nxjerrë më 4 mars 2019, ndërsa në bazë të fletëkthesës së dorëzuar nga Gjykata Themelore në Pejë, rezulton se Aktgjykimi i Gjykatës Themelore i ishte dorëzuar parashtruesit të kërkesës në Qendrën e Paraburgimit në Mitrovicë, më 12 mars 2019.
110. Në këtë aspekt, Gjykata konsideron se, ndonëse Gjykata Supreme mund të mos jetë përgjigjur në secilën pikë të mundshme të ngritur nga parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë, ajo i ka adresuar pretendimet thelbësore të parashtruesit të kërkesës për sa i përket zbatimit të të drejtës materiale dhe procedurale (shih, mutatis mutandis, rastet e GJEDNJ-se: Van de Hurk kundër Holandës, paragrafi 61; Buzescu kundër Rumanisë, cituar më lart, paragrafi 63; dhe Pronina kundër Ukrainës, kërkesa nr. 63566/00, Aktgjykim i 18 korrikut 2006, paragrafi 25, shih rastin e Gjykatës KI194/18, parashtrues Kadri Muriqi dhe Zenun Muriqi, Aktvendim për papranueshmeri, i 5 shkurtit 2020, paragrafi 107).
111. Megjithatë, Gjykata konsideron se Gjykata Supreme ka mundur që ta adresojë/shtjellojë pretendimin e parashtruesit të kërkesës lidhur me mosdorëzimin personal të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, por kjo në vetvete-nuk e bën procesin kundërkushtetues sepse, nga dokumentet në dispozicion, rezulton se parashtruesit të kërkesës i ishte dorëzuar Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Qendrën e Paraburgimit në Mitrovicë, si dhe parashtruesi i kërkesës dhe mbrojtësi i tij ishin njoftuar me përmbajtjen e tij gjatë shqyrtimit në seancën kryesore pranë Gjykatës Themelore ku edhe ishte shpallur publikisht (shih paragrafin 93-94 dhe paragrafin 97-98).
112. Prandaj, nën dritën e asaj që u tha më lart, në lidhje me këtë pretendim, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk e ka mbështetur këtë pretendim të tij dhe rrjedhimisht ky pretendim refuzohet si qartazi i pabazuar.

Pretendimi për mostrajtim të ankesës së parashtruesit të kërkesës, të 10 dhjetorit 2019, nga ana e Gjykatës së Apelit

113. Gjykata do t'i referohet edhe pretendimit të fundit të parashtruesit të kërkesës, i cili thekson/prendon se më 6 dhjetor 2019, kishte pranuar personalisht Aktgjykimin [DTKD.K.nr.112/2018] e Gjykatës Themelore të 4 marsit 2019 dhe

për pasojë më 10 dhjetor 2019, pas vendosjes në merita nga Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [PAKR. nr. 206/2019] të 16 majit 2019, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesën kundër Aktgjykimit [DTKD.K.nr.112/2018] të Gjykatës Themelore në Gjykatën e Apelit, por që sipas tij ankesa nuk ishte trajtuar në merita nga kjo e fundit por vetëm kishte lëshuar një shënim zyrtar si përgjigje ndaj ankesës së parashtruesit.

114. Gjykata rikujton se Aktgjykimi [DTKD.K.nr.112/2018] i Gjykatës Themelore, të 4 marsit 2019, ishte dorëzuar në Qendrën e Paraburgimit në Mitrovicë, më 12 mars 2019, ndërsa pas vendosjes në merita të rastit përmes Aktgjykimit [PAKR.nr.206/2019] të Gjykatës së Apelit të 16 majit 2019, si pasojë e iniciimit të ankesës së Prokurorisë Themelore të Pejës, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur ankesë kundër vendimit të shkallës së parë më 10 dhjetor 2019 në Gjykatën e Apelit, ndonëse rasti ishte vendosur më herët nga kjo e fundit përmes Aktgjykimit [PAKR.nr.206/2019] të 16 majit 2019.
115. Gjykata e Apelit ndaj shkresës/ankesës së 10 dhjetorit 2019, i ishte përgjigjur përmes një shënimi zyrtar, ku kishte theksuar se “Nga shikimi në procesverbal të kolegjit, rezulton që i pandehuri fare nuk ka përmendur faktin që në asnjë mënyrë nuk pajtohet me ankesën e përmendur nga ana e mbrojtësit të tij dhe as nuk i ka dhënë gjykatës ndonjë informatë që nuk ka pranuar aktgjykimin”.
116. Gjykata sjellë në vëmendje se parashtruesi i kërkesës është duke sfiduar kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [Pml. nr. 265/2019], të 9 tetorit 2019, të Gjykatës Supreme, por jo edhe kushtetutshmërinë e Shënimit Zyrtar të 17 janarit 2020 të Gjykatës së Apelit, i cili tashmë është kontestuar nga ana e parashtruesit në Gjykatën Supreme.
117. Në këtë aspekt, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës “Shënimin Zyrtar” të 17 janarit 2020 e kishte kontestuar në Gjykatën Supreme.
118. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se as nga dosja e lëndës por as nga vetë parashtruesi i kërkesës, Gjykata nuk ka njohuri nëse Gjykata Supreme ka nxjerrë ndonjë përgjigje në lidhje me ankesën e 10 shkurtit 2020 të paraqitur nga ana e parashtruesit të kërkesës dhe se nuk është njoftuar për statusin e kësaj çështje.
119. Gjykata rikujton se rregulli për shterimin e mjeteve juridike sipas nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 47 të Ligjit dhe rregullit 39 (1) (b) të Rregullores së punës, i obligon ata që dëshirojnë të paraqesin rastin e tyre në Gjykatën Kushtetuese që së pari duhet të shfrytëzojnë mjetet juridike efektive në dispozicion në pajtim me ligjin, kundër një aktgjykimi ose vendimi të kontestuar.
120. Në këtë mënyrë, gjykatave të rregullta u jepet mundësia që të korrigjojnë gabimet e tyre përmes procedurave gjyqësore të rregullta para se rasti të vijë në Gjykatën Kushtetuese. Ky rregull bazohet në supozimin e shprehur në nenin 32 të Kushtetutës dhe nenin 13 të KEDNJ-së, që në legjislacionin vendës ka mjete juridike në dispozicion për t'u shfrytëzuar pranë gjykatave të rregullta në lidhje me shkeljen e pretenduar, pavarësisht nëse dispozitat e KEDNJ-së janë inkorporuar në të drejtën nacionale apo jo (shih rastin e Gjykatës nr. KI19/20, parashtrues Lutfi Shantir, Aktvendim për papranueshmëri, i 22 korrikut 2020,

paragrafi 36; dhe shih rastin e GJEDNJ-së, Aksoy kundër Turqisë, paragrafi 51 i Aktgjykimit i 18 dhjetorit 1996).

121. Parimi është se mekanizmi mbrojtës, i krijuar nga Gjykata Kushtetuese të jetë subsidiar në raport me sistemin e rregullt gjyqësor që mbron të drejtat e njeriut (shih, ndër të tjera, Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar, paragrafi 48 i Aktgjykimit të GJEDNJ-së të 7 dhjetorit 1976).
122. Në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës duhet të ketë një rrugë të rregullt deri te mjetet juridike të cilat janë në dispozicion dhe të mjaftueshme për të siguruar një mundësi për të korrigjuar shkeljet e pretenduara. Ekzistimi i mjeteve juridike në fjalë duhet të jetë mjaft i sigurt jo vetëm në teori, por edhe në praktikë, dhe nëse nuk është kështu, atëherë këtyre mjeteve juridike do t'iu mungojë disponueshmëria dhe efektiviteti i nevojshëm (shih, inter alia, Vernillo kundër Francës, paragrafi 27 i Aktgjykimit të GJEDNJ-së i 20 shkurtit 1991, dhe Dalia kundër Francës, paragrafi 38 i Aktgjykimit të GJEDNJ-së i 19 shkurtit 1998).
123. Gjykata duhet të shqyrtojë nëse janë shteruar mjetet juridike dhe nëse mjeti juridik ishte efektiv, në dispozicion në teori dhe praktikë në kohën përkatëse, përkatësisht, që ka qenë i qasshëm, që ka mundur t'i korrigjojë shkeljet në lidhje me kundërshtimet e parashtruesit të kërkesës, dhe gjithashtu ka ofruar një perspektivë të arsyeshme për sukses (shih, inter alia, Civet kundër Francës, paragrafët 42-44 të Aktgjykimit të GJEDNJ-së, të 28 shtatorit 1999).
124. Megjithatë, kur një mjet juridik parashikohet me ligj, i takon parashtruesit të kërkesës të dëshmojë se mjeti juridik i paraparë me ligj është shteruar me të vërtetë ose për ndonjë arsye nuk ka qenë në dispozicion dhe ka qenë joefektiv në rrethanat e posaçme të rastit, ose ka pasur rrethana të veçanta për shkak të të cilave ai ose ajo kanë qenë të liruar nga kushti i shterimit të mjeteve juridike.
125. Duke iu kthyer rrethanave të rastit konkret, Gjykata vëren se shënimi zyrtar i 17 janarit 2020 është kontestuar në Gjykatën Supreme dhe nuk ka njohuri nëse Gjykata Supreme ka nxjerrë ndonjë përgjigje në lidhje me ankesën e 10 shkurtit 2020.
126. Prandaj, Gjykata, duke marrë parasysh parimin e subsidiaritetit dhe duke u bazuar në praktikën e saj gjyqësore thekson se nëse procedurat janë në zhvillim e sipër pranë gjykatave të rregullta, atëherë kërkesat e parashtruesve në Gjykatën Kushtetuese konsiderohen të parakohshme (shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës: KI09/19, parashtrues Leutrim Hajdari, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 shkurtit 2019, paragrafi 41; KI23/10, parashtrues Jovica Gadžić, Aktvendim për papranueshmëri, i 19 shtatorit 2013, paragrafi 47; dhe KI102/16, parashtrues Shefqet Berisha, Aktvendim për papranueshmëri, i 2 marsit 2017, paragrafi 39).
127. Bazuar në sa më sipër, Gjykata e refuzon këtë pretendim si të papranueshëm, pasi që parashtruesi i kërkesës nuk i ka shteruar mjetet e rregullta juridike në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (b) të Rregullores së punës.

128. Për sa i përket pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për shkelje të neneve 21 [Parimet e Përgjithshme], 23 [Dinjiteti i Njeriut], 24 [Barazia para Ligjit], 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë], 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit], 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale], 40 [Liria e Shprehjes], 41 [E Drejta e Qasjes në Dokumente Publike], 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave], dhe 59 [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtareve të Tyre] të Kushtetutës, Gjykata vlerëson se këto pretendime nuk do t'i nënshtrohen vlerësimit kushtetues për shkak se nuk ngrenë ndonjë çështje të re që nuk është trajtuar më parë në kuadër të nenit 30, 31 dhe 32 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së (shih, mutatis mutandis, rastet e Gjykatës nr. KI65/15, parashtrues Tatjana Davila, Ljubiša Marić, Zorica Kršenković, Zlatoj Jevtić, Aktgjykim i 14 shtatorit 2016; dhe nr. KI193/18 parashtrues Agron Vula, Aktgjykim i 22 prillit 2020).

Përfundim

129. Prandaj, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit të kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese sepse parashtruesi i kërkesës nuk dëshmon dhe nuk mbështet në mënyrë të mjaftueshme pretendimet e tij, dhe rrjedhimisht e njëjta nuk i përmbush kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës. Në pajtueshmëri me arsyetimin e këtij aktvendimi, kërkesa e parashtruesit të kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, me përjashtim të dy pretendimeve specifike të ngritura nga parashtruesi i kërkesës në kontekst të pretendimit për shkeljen e të drejtave të të akuzuarit si rezultat i mungesës së kohës për ta përgatitur mbrojtjen si dhe pretendimi për mostrajtim të ankesës së 10 dhjetorit 2019 nga Gjykata e Apelit, të cilat pretendime refuzohen si pretendime të papranueshme në baza procedurale për shkak të mosshterimit substancial të të gjitha mjeteve juridike, dhe rrjedhimisht nuk i përmbushin kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, paragrafin 2 të nenit 47 të Ligjit dhe pikën (b) të paragrafit (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 47. 2 të Ligjit dhe rregullat 39 (1) (b) dhe (2), si dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 9 mars 2022, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË, kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese



Remzije Istrefi-Peci



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Gresa Caka-Nimani